

Aneksi A  
PROCEDURA TREGUESE E SHPRONËSIMIT

*Procedura e mëposhtme e shpronësimit e paraqitur nga Autoriteti Kontraktues është përshkruese, jo detyruese dhe jepet vetëm për qëllime informimi.*

(Në mbështetje të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, 'Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, Pronë Private për Intere Publik', këtej e tutje 'Ligji i Shpronësimeve')

- Shpronësimi kryhet vetëm për interes publik i cili nuk mund të realizohet ose mbrohet në ndonjë mënyrë tjetër. (D.m.th në këtë rast për kryerjen e projekteve dhe investimeve që përfaqësojnë shtrirjen territoriale kombëtare ose lokale ose interes në energji.
- Subjekti privat ose pala e interesuar paraqet një kërkesë për shpronësim Këshillit të Ministrave, i cili me propozimin e Ministrit, organi kompetent sipas Ligjit të Shpronësimeve, vendos mbi shpronësimin. Kur shpronësimi bëhet në bazë të kërkesës së një individi/subjekti privat, Ministri përgjegjës me tagrin e përfaqësuesit të pronës shtetërore, është i autorizuar nga ligji, që mbi bazën e kërkesës paraprake të subjektit, të kryejë transferimin e pronave të shpronësuara në favor të subjektit privat i cili ka aplikuar për shpronësimin me kusht që të provohet kryerja e investimit ose ndërtimit në interes publik. Nëse subjekti privat nuk kërkon transferimin e pronës, ajo mbetet në pronësi të shtetit.
- Personi i interesuar i paraqet kërkesën ministrisë përgjegjëse për këtë veprimtari, së bashku me dokumentat e përcaktuar në nenin 10 të Ligjit të Shpronësimeve.
- Në Ministrinë përgjegjëse të linjës krijohet një Komision i Posaçëm për shpronësimet. Nëse Ministria, me anë të Komisionit të Posaçëm, bindet që dokumentet janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe vendimeve qeveritare, vendos të pranojë kërkesën për shpronësim dhe njofton personin që ka bërë kërkesën.
- Brenda 10 ditëve nga kryerja e njoftimit të mësipërm, parashikohet që Ministria do të lidhë një kontratë me personin që ka bërë kërkesën.
- Brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, Ministria fillon procedurat në lidhje me pronarët që preken nga shpronësimet. Ndërkohë publikohet një njoftim publik në gazetën zyrtare dhe në gazeta kombëtare dhe locale që gëzojnë reputacion të mire. Këto njoftime publikohen për një javë rresht.
- Një muaj pas dates së fundit të publikimit, ministria i paraqet Qeverisë propozimin për shpronësim, në mënyrë që të marrë vendimin përfundimtar.
- Subjekti në dobi të të cilit është bërë shpronësimi i paraqet ministrisë përgjegjëse sipas ligjit, kërkesën për shpronësim. Kërkesa do të shoqërohet nga dokumentat e mëposhtme:
  - Dokumenta zyrtarë që vërtetojnë statusin dhe regjistrimin e tij si person juridik
  - Projektimet e nevojshme, të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentat përkatëse ligjore mbi interesin publik që lidhet me realizimin e këtyre projekteve.
  - Dokumentacionin që lidhet me burimin dhe garancinë e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë ato për shpronësimin ose për shkak të zhvlerësimit.
  - Një vlerësim paraprak të objekteve të shpronësimit dhe shumën e kompensimit që parashikohet për çdo pronar privat.
  - Liçensat dhe lejet e nevojshme të organeve kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet.
  - Dokumentet zyrtarë që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit nga kërkuesi i shpronësimit.
  - Një listë e pronarëve të pronave private, për të cilat kërkohet shpronësimi; një listë e pronarëve të pronave private që janë zhvlerësuar për shkak të shpronësimit si dhe një listë të palëve të treat të cilat duhet të kompensohen për të drejtat e tyre në pronat private që kërkohen të shpronësohen, bashkë me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilën prej tyre, me përlogaritjet përkatëse të vlerës së këtyre

pronave dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimet e fundit të njohura të pronarëve përkatës dhe personave të tretë.



(Shënim: ekzistojnë rregullore të detajuara mbi përmbajtjen dhe standartet që duhet të respektohen në përpilimin dhe paraqitjen e dokumentave).

- Njoftimi Publik – 10 ditë nga nënshkrimi i kontrates ndërmjet Ministrisë dhe personit që ka bërë kërkesën, Ministria fillon procedurat përkatëse në lidhje me pronarët e pronave të prekura. Ndërkohë, do të botohet për një javë rresht një njoftim publik në gazetën zyrtare..

Përcaktimi i vlerës së truallit – mesatarja e çmimit të shitjes në rajon sipas regjistrimeve në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP). Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e jo më shumë se 3 muajve të fundit nga data e kërkesës së zyrës për shpronësim. Në rastet kur nuk ka pasur asnjë kontratë shitje gjatë kësaj periudhe, Komisioni i Posaçëm cakton çmimin bazuar në rregullat e përshkruara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar. Çmimi i vendosur sipas këtij vendimi mund të kundërshtohet dhe pronarët kanë të drejtë të kërkojnë rilogaritje të kompensimit nga gjykata – megjithatë kjo nuk sjell ndërprerjen e procedurave të shpronësimit.

**Kufijtë kohor tregues për procedure e shpronësimit janë si më poshtë:**

1. Brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të Koncesionarit për miratimin e shpronësimit, duhet të lidhet një kontratë ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues.
2. Autoriteti Kontraktues, brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontrates, do të fillojë procedurat e njoftimit për çdo pronar ose bashkëpronar të pronave dhe publikimit e kërkesës për shpronësim në interes publik.
3. Brenda 15 ditëve nga data e publikimit personat e interesuar kanë të drejtë t'i paraqesin pretendimet e tyre Autoritetit Kontraktues.
4. Autoriteti Kontraktues nuk mund t'i kërkojë Këshillit të Ministrave të marrë vendimin e shpronësimit përpara 1 muaji nga data e përfundimit të procedurave dhe kufijve kohorë të njoftimit të pronarëve dhe publikimit të kërkesës për shpronësim.
5. Brenda 15 ditëve nga data e njoftimit ose kufiri kohor i publikimit, pronari ose personat e interesuar duhet të njoftojnë Autoritetin Kontraktues nëse bien dakort për të transferuar pronësinë, në përputhje me kushtet e percaktuara nga Ministri.
6. Brenda 15 ditëve, nga dhënia e përgjigjes nga personat e përmendur më sipër (pika 5), por në çdo rast jo më parë se një muaj nga data e fundit e kufirit kohor të publikimit, duhet të përfundohet transferimi i pronësisë.
7. Pronat e shpronësuara duhet të regjistrohen brenda 30 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Ministrave.
8. Në rast se Koncesionari që ka kërkuar shpronësimin nuk fillon punimet brenda 3 muajve nga datat e percaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, shpronësimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

Aneksi B  
LISTA TREGUESE E AUTORIZIMEVE TË NEVOJSHME PËR NDËRTIMIN E  
HIDROCENTRALIT

*Kjo listë, e përpiluar nga Autoriteti Kontraktues, është përfshirë, jo e detyrueshme dhe jepet vetëm për qëllime informimi. Autorizimet e kërkuara më poshtë janë liçensat dhe lejet kryesore të kërkuara nga ligji për ndërtimin dhe operimin e një hidrocentrali.*

Pas përfundimit të procedurave të tenderit; dhënies dhe nënshkrimit të kontrates së koncesionit duhet të plotësohen procedurat dhe dokumentet e mëposhtme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një hidrocentrali.

**1. Leja e koncesionit e lëshuar nga Këshilli i Ujit përkatës**

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 27, date 19.01.2007, pasi aprovohet marrëveshja e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit, koncesionari do të aplikojë për marrjen e lejes koncesionare për përdorimit të ujit pranë këshillit përkatës të ujit. Këshilli i ujit duhet ta japë lejen koncesionare për përdorimin e ujit brenda 30 ditëve nga bërja e kërkesës. Leja koncesionare e përdorimit të ujit jepet në përputhje me ligjin nr. 8093, date 21.04.1996 "Për rezervat ujore" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 289, date 15.4.2005 "Për përcaktimin e kërkesave dhe të procedurave për miratimin e lejeve, të autorizimeve dhe të koncesioneve për përdorimin e ujit". Aplikimi kryhet me anë të formularit standard të përgatitur nga këshilli i ujit.

**2. Leja e Sheshit të Ndërtimit**

Kërkesa për t'u paisur me miratimin e sheshit të ndërtimit dhe studimin urbanistik është e detyrueshme të kryhet nga çdo person fizik ose juridik që ka për qëllim të ndërtojë një objekt ndërtimi, në sipërfaqe ose nëntokë.

Kërkesa i paraqitet Drejtorisë së Urbanistikës në Këshillin Bashkiak, ose në zyrën e urbanistikës në bashki ose në komunë. Vendndodhja e shesheve të ndërtimit dhe kushtet e tyre urbane janë paraqitur në Planet e Përgjithshme Rregulluese ose në studimet e pjesshme urbanistike. Kërkesa për miratimin e vendndodhjes funksionale dhe kushteve urbanistike të sheshit mund të kryhet vetëm nga pronari i tokës. Për sheshet e ndërtimit që janë prone publike, mund të paraqitet më shumë se një kërkesë. Këshilli i Zonës, Këshilli Bashkiak dhe Këshilli i Komunës shqyrtojnë kërkesat, sipas rregullave për ofertat konkurruese dhe zgjedhin ofertën që i përmbush më mirë kushtet financiare, ekonomike, sociale, urbanistike, arkitekturore dhe mjedisore.

Nëse organet e qeverisjes lokale kanë inters në ndërtime mbi pronën publike ata duhet të fillojnë procedurat e tenderimit.

Për të aplikuar për një leje sheshi ndërtimi duhen paraqitur dokumentat e mëposhtme:

1. Në rast se janë të nevojshme, Formulari i Aplikimit 1 dhe 6 (për prerjen e drurëve) dhe 8 (prishja e ndërtesave ekzistuese);
2. Çertifikatën e pronësisë dhe hartat treguese;
3. Gen-planin e tokës;
4. Të dhëna të tjera nga agjensite dhe ndërmarrjet përkatëse (furnizimi me ujë, kanalizimet, telekom, etj);
5. Studim urbanistik pjesor të zonës së ndërtimit, i përgatitur nga një Arkitekt i liçensuar;
6. Planvendosjen e objektit;
7. Projektidenë e objektit;
8. Raportin Shpjegues të studimit dhe projektit;
9. Sistemet e jashtme, sheshet, zonat e gjelbërta, vendparkimet, rrugët dhe skemat e lëvizjeve të këmbësoreve;

10. Fotomontazhin e objektit mbi foton e gjëndjes ekzistuese;
11. Kontratet me pronatët e pronave kufitare, duke detajuar numrin e pronave të pronarëve kufitar.
12. Lejen nga Institucioni i Monumenteve të Kulturës, lidhur me zonat që janë në mbrojtje nga Institucioni;
13. Vërtetim nga Instituti Gjeologjik (për ndërtime mbi 3 kate) dhe Instituti Sizmik (për ndërtime mbi 8 kate);
14. Dokumentin fotografik të zonës;
15. Deklaratë noteriale nga pronari për personat e pastrehë që banojnë në prona private.

Kërkuuesi duhet të dorëzojë një formular aplikimi të plotë të shoqëruar nga dokumentet përkatëse zyrës së urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore përkatëse. Njësia e qeverisjes vendore është ligjërish e detyruar të vendosë brenda 60 ditëve.

### 3. Leja e ndërtimit

Cilido që ka për qëllim të ndërtojë në territorin shqiptar duhet të pajiset me një leje ndërtimi. Leja e ndërtimit i jepet personit juridik që është i licensuar si ndërtues. Sipas ligjit no 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" zbatimi i punimeve të ndërtimit duhet të kryhet nga ndërtues të licensuar në përputhje me ligjin. Licensimi i ndërtuesve parashikohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 13.12.1993 "Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim dhe projektim të shoqërive". Sipas këtij vendimi çdo shoqëri që sunon të kryejë aktivitete në fushën e ndërtimit dhe projektimit duhet të jetë e regjistruar në Regjistrin e Licensave Profesionale, në Ministrinë e Punëve Publike.

Transferimi ose kalimi i lejes së ndërtimit është i ndaluar.

Leja e ndërtimit miratohet brenda 45 ditëve nga bërja e kërkesës.

Ndërtimet në zonat me rëndësi turistike përcaktohen në planet urbanistike rajonale dhe në strategjinë kombëtare për zhvillimin e turizmit.

Dokumentet që duhen paraqitur për t'u pajisur me leje ndërtimi janë si më poshtë:

1. Leja e miratuar e sheshit të ndërtimit;
3. Raporti teknik për studimin e projektit;
4. Kopje të noterizuara të licensave të projektuesve;
5. Të dhëna gjeologjike dhe inxhinierike për sheshin e ndërtimit;
6. Të dhëna inxhinierike dhe sizmike për sheshin e ndërtimit;
7. Projekti i plotë;
8. Llogaritjet bazë të projektit;
9. Planimetria e sistemimeve të jashtme;
10. Grafiku i punimeve;
11. Preventivi;
12. Çertifikata nga Inspektorati i Mjedisit Urban.

### 4. Lejet Mjedisore

Sipas ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002, "Për mbrojtjen e mjedisit", personat juridik janë të detyruar të pajisen me miratimet e nevojshme për aktivitetet që ndikojnë ose mund të ndikojnë në mjedis. Miratimi i kërkesës bëhet pasi të paraqiten miratimet përkatëse nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (këtej e tutje "Ministria e Mjedisit") të cilat sipas përcaktimeve të ligjit mund të jenë në formën e një deklaratë mjedisore, leje mjedisore apo dhënie pëlqimi dhe autorizimi mjedisor.

Në mënyrë që të ndërmerren dhe zbatohen projekte, strategji dhe plane zhvillimi të caktuara, përpara se të jepet leja mjedisore nevojitet të merret një deklaratë mjedisore.

Sipas legjislationit mjedisor, Ministri i Mjedisit shpreh mendimin e tij zyrtar për projektin, strategjinë ose planin e zhvillimit nëpërmjet deklaratës mjedisore, vetëm pasi ka shqyrtuar

dokumentacionin dhe është konsultuar me palët e interesuara. Deklarata mjedisore merret brenda 3 javëve nga data e bërjes së kërkesës. Sipas informacionit të marrë nga Ministria e Mjedisit duhet paguar një tarifë prej 90.000 Lek.

Shfrytëzimi i pasurive minerare dhe burimeve natyrore, si dhe çdo veprimtari tjetër që ndikon në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave pas propozimit të Ministrit të Mjedisit.

#### 4.1 Dokumentet që kërkohen për marrjen e lejes mjedisore

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 24.4.2003 dhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave nr. 1, datë 07.1.2008, për marrjen e lejes mjedisore duhet të dorëzohen dokumentat e mëposhtme:

- Kërkesa
- Dokumentacioni teknik;
- Dokumentacioni ligjor (dmth Çertifikata e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit që vërteton regjistrimin e kërkuarit);
- Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i hartuar nga ekspertë të licensuar të zgjedhur nga kërkuari, persona fizik ose juridik.
- Informacione për konsultimet e mbajtura me publikun dhe palët e interesuara së bashku me verbalin dhe dokumentat e prezantuar gjatë mbledhjes, lista e pjesëmarrësve, fotografi etj.);
- Deklaratë e kërkuarit që nxjerr në pah pretendimet e publikut; NGO-ve, etj.;
- Opinioni i autoriteteve vendore për aktivitetin që do të kryhet;
- Fatura për pagimin e tarifës së lejes mjedisore në shumën 50 000 Lek.

#### 4.2 Procedura për marrjen e një leje mjedisore

Sipas ligjit për mbrojtjen mjedisore dhe ligjit nr. 8990, datë 23.1.2003, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", aplikimi i dorëzohet Agjencisë Rajonale Mjedisore (këtej e tutje ARM). ARM, brenda 20 ditëve, i jep Ministrisë së Mjedisit një mendim me shkrim për aplikimin. Gjatë fazës përpunimit të dokumentave, Ministri krijon një komision që bën propozime për vendimin. Ministri duhet të pyes të gjithë palët e interesuara për pritshmëritë e tyre nga projekti. Gjithashtu, duhet të organizohet një debat publik që të drejtohet nga autoritetet vendore. Koha maksimale për marrjen e lejes mjedisore është 5 javë nga data e aplikimit.

### 5. Liçensa nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për prodhimin e energjisë

Sipas ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", the Enti Rregullator i Energjisë jep liçensa për aktivitetet e mëposhtme:

- i. prodhimin e energjisë elektrike;
- ii. transmetimin e energjisë elektrike;
- iii. shpërndarjen e energjisë elektrike;
- iv. furnizimin me shumicë të energjisë elektrike;
- v. furnizimin me pakicë të energjisë elektrike
- vi. furnizimin e klientëve të veçantë me energji elektrike; dhe
- vii. tregtimin e energjisë elektrike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për çdo aktivitet objekt liçensimi, të kryera nga i njëjti person do të lëshohen liçensa të veçanta. Çdo kërkesë për liçensë paraqitet sipas formularit standard të përcaktuar nga ERE. Paragrafët e mëposhtëm përcaktojnë procedurat e veçanta të liçensimit, së bashku me të gjitha dokumentet që kërkohen.

#### 5.1 Dokumentet

Kërkuesit i jepet një formular standad aplikimi. Dokumentat e mëposhtme duhet të bashkëngjiten me formularin:

- a. Dokumente ligjore, administrative dhe të pronësisë
- b. Dokumente financiare dhe fiskale
- c. Dokumenta teknik që kanë të bëjnë me hidrocentralin
- d. Liçensa nga institucione të tjera

## 5.2 Procedurat e liçensimit

Në rast se ERE miraton fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për t'u pajisur me liçensë, atëherë brenda 3 ditëve, ai publikon njoftimin për kërkesën në 3 gazeta të përditshme kombëtare për dy ditë rresht. Njoftimi përmban një informacion të shkurtër për kërkesën dhe gjithashtu përmban lajmërimin që palët e treta mund të paraqesin kundërshtimet ose pretendimet e tyre, brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e ERE-s për Procedurat e Liçensimit. Publikut i vihen në dispozicion kërkesa dhe dokumentet shoqëruese të kërkuesit përgjatë 2 muajve. Gjatë periudhës së sipërpërmendur mund të kërkojë dokumente të tjera nga kërkuesi, që duhet të dorëzohen në formën dhe afatin përcaktuar nga ERE. ERE ka të drejtë ta refuzojë kërkesën, në rast se kërkuesi nuk përmbush këto detyrime.

ERE merr një vendim përfundimtar për dhënien ose refuzimin e dhënies së liçensës brenda 90 ditëve nga dita e publikimit të parë të njoftimit për kërkesën.

## 6. Vlerësimi teknik i projektit nga Qeveria

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 191, datë 22.3.2007, të gjitha projektet për ndërtimin e hidrocentraleve me koncesion do t'i nënshtrohen një vlerësimi teknik nga një grup ekspertësh të shquar në fushën hidro-teknologjike, inxhinierike, ligjore, ekonomike, gjeologjike etj. Ekspertët do të bëjnë vlerësimin e projektit duke pasur parasysh shfrytëzimin optimal të burimeve ujore dhe do të kryejnë kontrollin teknik të këtij projekti bazuar në kërkesat e ligjit "Për rezervat ujore" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e Punimeve të ndërtimit" (i ndryshuar).

Pas përfundimit të vlerësimit, ekspertët hartojnë një raport i cili do të shqyrtohet dhe miratohet me shumice votash nga Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Ujore. Raporti vlerësues dhe vendimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Ujore janë pjesë përbërëse e dokumentacionit dhe i dërgohen Autoritetit Kontraktues (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë) për të vazhduar me procedura e dhënies së koncesionit.

Gjithashtu, sipas ligjit "Për kontrollin dhe disiplinimin e Punimeve të ndërtimit" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 363, datë 18.7.2002, projektet e ndërtimit që kanë një vlerë të përlogaritur më të madhe se 100 million Lek i nënshtrohen një vlerësimi teknik nga një institucion qeveritar. Investitori, paraqet kërkesën për vlerësim teknik, gjatë fazave të ndryshme si programimi i investimeve, dhenie e lejeve të sheshit dhe ndërtimit si dhe gjatë miratimit të zbatimit të projektit.

## 7. Miratimi nga OST për lidhjen dhe përdorimin e rrjetit

Aktiviteti i prodhimit të energjisë elektrike prezumohet që përfshin edhe lidhjen me rrjetin e transmetimit. Një nga të drejtat e prodhuesit të liçensuar të energjisë elektrike është të ketë të drejtën e lidhjes me rrjetin e transmetimit pas pagesës së tarifës së transmetimit të përcaktuar nga ERE.

Për të pasur të drejtën e lidhjes me rrjetin e transmetimit, i liçensuari duhet të përmbushë disa kërkesa dhe të dorëzojë dokumenta të caktuara operatorit të sistemit të transmetimit, OST. Kodi i Transmetimit, i miratuar nga ERE me vendimin nr. 123 datë 24.10.2008, përcakton në mënyrë më të hollësishme rregullat dhe procedurat në lidhje me sa më sipër.

Kërkesa drejtuar OST për lidhjen me rrjetin e transmetimit duhet të përmbajë informacionet dhe dokumentet e mëposhtme, megjithatë OST mund të kërkojë informacione shtesë në varësi të çështjes:

- (i) Emri, adresa, telefoni/faksi/posta elektronike (e-mail) të kërkuarit;
- (ii) Qëllimi i lidhjes (njësi prodhuese, pajisje shpërndarëse, etj.);
- (iii) Zotimin me shkrim të kërkuarit për të respektuar Kodin e Transmetimit;
- (iv) Dokumentacionin për nivelin e voltazhit që kërkuari do të lidhet.

OST duhet ta pranojë ose refuzojë kërkesën brenda 60 ditëve nga data e aplikimit. Në rast se kërkohen informacione shtesë, afati mund të zgjatet edhe me 30 ditë nga data që dorëzohen informacionet shtesë. Afati për dorëzimin e informacioneve është 20 ditë. OST mund të refuzojë kërkesën, në rast se nuk merr informacionet shtesë brenda afatit të përcaktuar më sipër. Miratimi teknik nga OST jepet brenda 90 ditëve nga data e aplikimit, në rast se të gjitha dokumentet u dorëzuar në të njëjtën datë.

Pas marrjes së miratimit nga OST, kërkuari lidh një kontratë me këtë operator. Në kontratë përfshihen kushtet e përgjithshme për lidhjen dhe kushtet specifike, teknike dhe financiare.

**Aneksi C**  
**FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES**

**GARANCI BANKARE/POLICE SIGURIMI**

Nr. ref. \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_

**Per :** Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes  
Blvd Deshmoret e Kombit nr.1001, Tirane

Duke qene se:

- (*emri i Ofertuesit Fitues*) eshte shpallur fitues ne Proceduren Konkurruese per Marrjen me Koncesion te HEC \_\_\_\_\_, me vendndodhje ne \_\_\_\_\_ sipas shkreses se Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (me poshte referuar si "Autoriteti Kontraktor"), Nr. \_\_\_ Prot, date \_\_\_\_\_ "Njoftimi i Fituesit" ; dhe
- Ofertuesi Fitues ka paraqitur prane nesh Draftin e Kontrates te lidhur ndemjet tij dhe Autoritetit Kontraktor, "Per marrjen me koncesion te HEC \_\_\_\_\_ ; dhe
- ne Kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne Kontrate; dhe
- (*emri i Bankes/i shoqerise se sigurimit*) eshte dakord te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:

jemi garantuesit e kontrates se siperpermendur deri ne shumen totale prej (*shuma ne shifer dhe fjale*), shume e cila eshte e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate ; dhe

marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej (*shuma e garancise*); dhe

per marrjen e kesaj garancie, nuk eshte nevoja t'i drejtoheni me pare Koncesionarit per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj; dhe

asnje shtese apo ndryshim i kushteve te Kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me Koncesionarin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin 30 dite nga data e leshimit te Certifikates se Perfundimit.

\_\_\_\_\_  
*Nenshkrimi dhe Vula e Bankes/Shoqerise se Siguri*



## Aneksi D

### UDHEZUESI I TESTIT TE PERFORMANCES

Koncesionari do të paraqesë një program të plotë Test Performance, në përputhje me praktikën Industrisë Mirë, e cila do të përfshijë:

- Një tregues për datën, kohën dhe kohështyrjen e testeve
- Procedura e detajuara për testet
- Suksesit ose dështimi për kriteret e testeve
- Sistemi për dokumentimin e rezultateve të testeve

Para dhe gjatë periudhës së testeve, Autoriteti Kontraktues do të ofrojë të gjitha informatat e kërkuara të arsyeshme nga Koncesionari për të lehtësuar zhvillimin e procedurave për teste. Nëse kërkohet nga secila prej Palëve dhe në njoftim të arsyeshëm, përfaqësues Autoriteti Kontraktor do të marrë pjesë në testet (në kurriz të Partisë që ka kërkuar një mënyrë).

Testet e Performancës në lidhje me një bimëve do të përfshijë:

- (a) Operimi i Sistemit te eksimtimit
- (b) Kapaciteti reaktiv
- (c) Testi i Ngarkeses
- (d) Kapaciteti minimal i vazhdueshëm, dhe
- (e) Test i kapaciteteve

Aftësitë e mëposhtme duhet të paraqiten:

- (i) se çdo njësi plotëson kapacitetet e instaluar për Njësinë e tilla
- (ii) se centrali i tillë i përmbush Kapacitetet e instaluar.

Njësia do të konsiderohet porositur kur testet e përshkruara më lart kanë qenë të gjitha përfunduar me sukses.

Me kusht që secila Njësi ka qenë i porositur në përputhje me paragrafët e mësipërm dhe bimëve të tilla ka qenë ndryshe porositur në të gjitha aspektet e tjera, koncesionari mund të deklarojë me anë të njoftimit për Autoritetin Kontraktues që Plant përkatëse ka qenë i porositur, nëse janë apo jo bimëve të tilla është i aftë për të arritur kapacitet të instaluar.

Çdo moskontrate në lidhje me Kapaciteti i instaluar do t'i referohen një ekspert teknik dhe ekonomik në pajtim me nenin 13.2 të kësaj Kontrateje

**Aneksi E**  
**Formulari i Njoftimit te Mbylljes Financiare**

date

**Per :** Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes  
Blvd Deshmoret e Kombit nr.1001, Tirane

RE: projekti hidroenergjitik Egnatia - Shushicë - Njoftimi i Mbylljes financiare

Referenca është bërë ne baze te Kontrates së Koncesionit që ka lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjitik në HEC Egnatia - Shushicë, Rrethi Elbasan - Librazhd, Republika e Shqipërisë ("Marrëveshja e Koncesionit"), nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë , Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë, si Autoriteti Kontraktues dhe

\_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_

koncesionari, në [=] 2012.

Termat me germa kapitale të përdorura dhe jo të përcaktuara në këtë Njoftim do të kenë kuptimin e përcaktuar në kushtet të tilla në kontraten e koncesionit.

Në përputhje me nenin 6.4 të Kontrates së Koncesionit, ne, të nënshkruarit, ne këtë rast konfirmojme se ne kemi siguruar një financim të tillë për të mbuluar një qind për qind (100%) të çmimit kapitalit të përgjithshëm të Projektit nëpërmjet kontrateve me çdo ose të gjithë Aksionerët dhe / ose palët e financimit për të siguruar financim në formë të ekuitetit dhe / ose borxhit të kompanisë Projektit në përputhje me zhvillimin e Projektit. Për shmangien e dyshimit, te fondeve te siguruar ne nje financim te tillë do të rrjedhin në kompanine e Projektit në mënyrë progresive në përputhje me kërkesat e tij financiare në fazën përkatëse të projektit.

\_\_\_\_\_  
KONCESIONARI

[Nenshkruesi i autorizuar]

**Aneksi H**  
**TË DHËNAT E QEVERISË**

Të dhënat që kërkohen nga Qeveria në lidhje me pasuritë e paluajtshme që ndodhen në zonën e Hidrocentralit Egnatia - Shushicë:

- Të dhëna të përditësuara nga Zyrat përkatëse Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që tregojnë të gjithë pasuritë e paluajtshme që preken nga ky projekt, të shoqëruara me hartat treguese të pasurive të paluajtshme.
- Të dhëna të përditësuara nga organet përgjegjëse mbi fondet pyjore që ndikohen nga ndërtimi i Hidrocentralit.

**ANEKSI G**  
**KASKADA E LUMIT GOSTIMË DHE DEGËT E SAJ**

Grafiku per Procedurat e pajisjes me lejet respektive nga Autoritetet perkatese (Dy vjet)

Nr	Emertimi	Afater kohore ne muaj																							
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
1	Pregatitja e Plote e Projektit te Zbatimit	█	█	█	█	█	█	█	█	█	█	█	█												
2	Kryerja e procedurave per miratimin nga Oponenca teknike.												█	█											
3	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe ujit.														█	█	█								
4	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Keshillin e basenit.														█	█	█								
5	Aplikim dhe marrja e lejeve ne njesite e Qeverisjes Vendore.														█	█	█								
6	Aplikim ne Zyrat kadastrale (harta e pronave).														█	█	█								
7	Aplikim dhe marrja e lejes per Lidhjen me sistemin.														█	█	█								
8	Paraqitja e projekteve ne Ministrine e Kultures.																								
9	Paraqitja e projekteve ne Ministrine e Punëve Publike dhe Transportit, Mbrojtja e Projekteve ne Sekretarinate teknike te saj.																								
10	Paraqitja e Projektit ne KRrTRSH dhe mbrojtja e saj.																								
11	Piketimi ne Terren I nenobjekteve te Hidrocentraleve.																								█
12	Totali.	24 Muaj																							

### HIDROCENTRALI "EGNATIA"

Grafiku per Procedurat e pajisjes me lejet respektive nga Autoritetet perkatese (Dy vjet)

Nr	Emertimi	Afatet kohore ne muaj																							
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
1	Pregatitja e Plote e Projektit te Zbatimit	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■											
2	Kryerja e procedurave per miratimin nga Oponente teknike.												■	■											
3	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe ujit.														■	■									
4	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Keshillin e basenit.														■	■									
5	Aplikim dhe marrja e lejeve ne njesite e Qeverisjes Vendore.														■	■									
6	Aplikim ne Zyrat kadastrale (harta e pronave).														■	■									
7	Aplikim dhe marrja e lejes per Lidhjen me sistemin.														■	■									
8	Paraqitja e projekteve ne Ministrine e Kultures.																								
9	Paraqitja e projekteve ne Ministrine e Punëve Publike dhe Transportit, Mbrojtja e Projekteve ne Sekretariate teknike te saj.																■	■	■	■					
10	Paraqitja e Projektit ne KRrTRSH dhe mbrojtja e saj.																				■	■	■	■	■
11	Piketimi ne Terren I nenobjekteve te Hidrocentraleve.																								■
12	Totali.	24 Muaj																							

### HIDROCENTRALI "FUSH BULLIT"

Grafiku per Procedurat e pajisjes me lejet respektive nga Autoritetet perkatese (Dy vjet)

Nr	Emertimi	Afatet kohore ne muaj																							
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
1	Pregatitja e Plote e Projektit te Zbatimit	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■												
2	Kryerja e procedurave per miratimin nga Oponenca teknike.												■	■											
3	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe ujit.															■	■								
4	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Keshillin e basenit.															■	■								
5	Aplikim dhe marrja e lejeve ne njesite e Qeverisjes Vendore.															■	■								
6	Aplikim ne Zyrtar kadastrale (harta e pronave).															■	■								
7	Aplikim dhe marrja e lejes per Lidhjen me sistemin.															■	■								
8	Paraqitja e projekteve ne Ministrine e Kultures.															■	■								
9	Paraqitja e projekteve ne Ministrine e Punëve Publike dhe Transportit, Mbrojtja e Projekteve ne Sekretarinate teknike te saj.															■	■	■	■						
10	Paraqitja e Projektit ne KRRTSH dhe mbrojta e saj.															■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
11	Pikëtimi ne Terren I nenobjekteve te Hidrocentraleve.																								■
12	Totali.	24 Muaj																							

### HIDROCENTRALI Nr. 3 "GOSTIMA 3"

Grafiku per Procedurat e pajisjes me lejet respektive nga Autoritetet perkatese (Dy vjet)																									
Nr	Emertimi	Afatet kohore ne muaj																							
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
1	Preparimi dhe miratimi i Projektit te Zbatimit	█	█	█	█	█	█	█	█	█	█	█	█												
2	Kryerja e procedurave per miratimin nga Oponenca teknike.												█	█											
3	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Ministriine e Mjedisit, Pyjeve dhe ujit.														█	█									
4	Aplikimi dhe marrja e lejeve ne Keshullin e basenit.														█	█									
5	Aplikim dhe marrja e lejeve ne njesite e Qeverisjes Vendore.														█	█									
6	Aplikim ne Zyrat kadastrale (harta e pronave).														█	█									
7	Aplikim dhe marrja e lejes per Lidhjen me sistemin.														█	█									
8	Paraqitja e projekteve ne Ministriine e Kultures.														█	█									
9	Paraqitja e projekteve ne Ministriine e Punëve Publike dhe Transportit, Mbrojtja e Projekteve ne Sekretariine teknike te saj.														█	█	█	█							
10	Paraqitja e Projektit ne KRrTRSH dhe mbrojta e saj.														█	█	█	█	█	█					
11	Pikeimi ne Terren I nenobjekteve te Hidrocentraleve.																								█
12	<b>Totali.</b>	<b>24 Muaj</b>																							

